



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

Legj. -III-

**KOMISIONI PARLAMENTAR PËR BUJQËSI, PYLLTARI,  
ZHVILLIM RURAL, MJEDIS DHE PLANIFIKIM  
HAPËSINOR**

Procesverbal **Nr. 14**  
nga mbledhja e mbajtur më **10.6.2008**  
kryesuar nga **Lulzim Zeneli**-kryetar i komisionit  
Mbledhja filloi në orën 13,00

**Të pranishëm :**

Lulzim Zeneli, Berat Luzha, Heset Cakolli , Kosara Nikolić, Elheme Hetemi, Zef Morina, Zylfi Merxha, Ali Lajçi, Ibrahim Selmanaj dhe Myrvete Pantina..

**Mungoi :**

Selvie Halimi.

**Nga Sekretaria e Kuvendit :** Bajram Badivuku, Lule Ymeri, Drita Çarkaxhiu.

**Pjesëmarrësit tjerë :** Ombudspersoni-Hilmi Jashari, Ministri i MMPH Mahir Yagcilar, përfaqësuesi i Komunës së Prizrenit, Blerim Vela dhe vëzhguesit e rregullt.

**RENDI I DITËS :**

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,**
- 2. Kërkesa e Ombudspersonit të Kosovës,**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit të produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, dhe**
- 4. Të ndryshme**

**Procesverbali nga mbledhja e kaluar**

**Kryesuesi Lulzim Zeneli** hapi mbledhjen dhe konstatoi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

## **Shkresa e Ombudspersonit dërguar Kuvendit të Kosovës lidhur me malet e Sharrit**

**Lulzim Zeneli** përsëriti shkurtimisht konstatimet nga mbledhja e kaluar lidhur me kërkesën-ankesën e Ombudspersonit rreth malit të Sharrit, përsëriti z. **Hilmi Jasharin** – ushtrues i detyrës së Ombudspersonit të Kosovës të cilin e ftoi që të njoftoi komisionin lidhur me shqetësimet e tij. I njëjti në fillim falënderoi për këtë reagim (caktimin e mbledhjes për këtë çështje) të komisionit dhe shprehu mendimin se institucioni i Ombudspersonit është dora e djathtë e Kuvendit jo vetëm për këtë rast, ndaj edhe në të ardhmen do të jetë kështu. Ai nuk deshi të elaboroi gjerësisht për këtë çështje, ngase shkresa nga ana e tij i është dërguar të gjitha institucioneve relevante. Ai shfaq shqetësimin sidomos (përveç ndërtimeve ilegale në malin e Sharrit) për ngritjen e gurthyesve në zonën e malit ku jetojnë shtazët e veçanta, ndaj pyeti : “cili shtazë mund të jetoj aty ku ka eksploziv, dinamit etj.” Ai me këtë rast alarmoi se gjendja është tepër e jashtëzakonshme dhe shqetësuese, njëherit e papranueshme poçes nuk ndërmerret diçka në këtë drejtim, sidomos nëse çështja shkon në Gjykatën Evropiane në Strasburg e cila me vendimet e saja (shumat e mëdha të dënimeve) mund ta shqetësoi bukur mirë Qeverinë tonë.

**Mahir Yagcilar** tha se MMPH vepron vetëm në kuadër të kompetencave ligjore, në këtë rast edhe për malet e Sharrit. Prevalci është fshat turistik, mirëpo me veprimet e fundit të komunës së Prizrenit gjërat janë komplikuar, ngase lejet për ndërtime janë dhënë por nuk janë respektuar sugjerimet nga MMPH dhe plani rregullativ në aplikim. Tani KK Prizren ka marr vendimin për stopimin e ndërtimeve. Asistenti i MMPH me anë të kinoprojektorit i tregoi komisionit këto ndërtime ilegale. Ministri përfundoi me sugjerim : të mëremi vesh që mos të veprohet jashtë suazave të vendimit të MMPH dhe të gjejme një rrugë për mbrojtjen e mjedisit në këtë fshat turistik, sepse këto probleme kanë filluar para tre vitesh.

**Nënkryetari i Komunës së Prizrenit** konstatoi se Prevalci i është grabit (nga Kosova) kësaj komune, sepse me planifikim ka qenë e paraparë shumë më pak të kemi kamp-shtëpiza dhe me ma pak dru të ndërtuara. Ai tha se kjo duhet të pengohet gjithsesi duke formuar një grup këtu në Kuvend, i cili urgjentisht duhet të rishikoj gjendjen e krijuar.

**Lulzim Zeneli** ju sqaroi të pranishmëve, sidomos mysafirëve, se komisioni ka për obligim të monitoroj se sa është zbatuar ligji, ndaj i luti të gjithë që në këtë drejtim të kontribuojnë në këtë takim të sotëm, dmth : sa është e argumentuar shkresa e dërguar nga Ombudspersoni, si është qasur KK Prizren lidhur me këtë çështje, sa janë tejkualuar autorizimet e administratës përkatëse, a ka shkelje të ligjit dhe KK Prizren a ka zbatuar planin rregullativ.

**Hilmi Jashari** kërkoi falje që shpreh emocionin por ai përsëriti se është duke pritur përgjigjen se a do të zbatohet rekomandimi i tij i propozuar apo jo, dhe çka mundet me ba ky komision lidhur me brengat e shfaqura (duke aluduar në rekomandimet eventuale për Kuvendin). Ai rikujtoi të pranishmëve se Parku në fjalë është rregulluar me një ligj statusor, çka do të thotë se ky ligj është parësor në çdo moment, sidomos në këto raste.

**Muhamet Aliu** tha se vendimi i MMPH është i bazuar në ligj, ngase pëlqimi i dhënë që KK të jap leje ndërtimore nuk do të thotë se MMPH është përgjegjëse, sepse ministria këtë e ka kushtëzuar, askush nuk ka thënë të ndërtohen objekte 300 m<sup>2</sup>, madje ministria nuk ka thënë se mund të kemi gurthyes, Shtërpcën nuk e menaxhon ministria. E gjithë kjo

çështje buron nga fakti se pronarët më herët kanë shitur lirë pronën, ndërkaq pastaj vendimi i Komunës ka krijuar atraksion, dhe kështu ka filluar problemi.

**Zef Morina** konstatoi se kjo çështje është gjithnjë duke u qartësuar sepse vendimi i MMPH (i bazuar në ligjin e PH) ka kërkuar të respektohet neni 12. Ai konstatoi se problemi është te Komuna dhe pyeti çka ka bërë komuna, pse ka toleruar. Mosefikasiteti i inspektionit të Komunës në këtë rast dikujt do ti kushtoi. Menjëherë duhet të stopohen këto ndërtime, përfundoi ai. **Muhamet Aliu** reagoi duke potencuar se fjala është për planin hapësinor për zonat e veçanta. Ndërkaq **nënkryetari i KK Prizren** reagoi duke argumentuar se zyrtarët e komunës kanë ndaluar punën e mëtejme të banorëve.

**Ali Lajçi** theksoi se kjo çështje është shumë e ndjeshme dhe profesionale, ndaj kërkoi mbrojtje të veçantë të ambientit, ngase si theksoi ai ne kemi edhe shumë zona tjera që duhet medoemos ti mbrojmë. Edhe **Berat Luzha** konstatoi pafajësinë e MMPH ngase ajo ka kërkuar respektimin e neneve të caktuara të ligjit, njëherit theksoi se pyjet nuk janë mbrojtur në këtë park, sepse pasi që ka pasur djegëje ato i ka përfshirë një sëmundje e cila edhe më tej i ka tharë ato dhe asgjësuar edhe më tutje, do të thotë se nuk është lejuar pastrimi i tyre apo rigjenerimi i tyre. Ai pyeti , pasi është kjo gjendje , pse nuk i lejohet dikujt të bëjë këtë (APK edhe me ligj është i obliguar). Pyetja e tij e fundit ishte për një ndërtim para lufte e cila nuk ka vazhduar pas lufte, për të cilin premtoi se do ti tregoi komisionit nëse vizitohet ky vend. **Elheme Hetemi** kërkoi që këto gjëra të ndalohen urgjentisht, të respektohen ligjet dhe të rekomandohet Kuvendi, por paraprakisht të miratohet plani i menaxhimit nga Kuvendi, ngase pa këtë miratim nuk mund të veprohet në atë drejtim se kush i ka lëshuar këto leje.

**Ibrahim Selmanaj** tha se këto objekte për të cilat po flitet sot (sidomos gurthyes) shihen me sy, ndaj dikush duhet të jap llogari. Komuna duhet të përgjigjet në disa pyetje : kush i ka lëshuar këto leje, kush ka monitoruar, si të veprohet me këta njerëz dhe me ata të cilët posedojnë kësi lloj lejesh etj. Ai sugjeroi të vizitohet ky vend i ngjarjes.

**Zylfi Merxha** ishte kategorik se kemi të bëjmë me një fajësi zingjirore (funksionarët e lartë nga ish mandati) , ngase si tha ai “fukaraja këtu nuk ka mund të hyj”. **Myrvete Pantina** gjithashtu pyeti pyetje të ngjashme dhe insistoi të merën në përgjegjësi ata që kanë lejuar këto gjëra, sepse në këtë rast komuna ka dështuar. Bashkëpunatori i Ombudspersonit z. **Morina** tha se drejtoria e parkut ka bërë një raport për planin “Prevalla” dhe kjo paraqet vetëm një pjesë.

Pasi që mysafirët e ftuar u larguan nga mbledhja , **Lulzim Zeneli** i falënderoi , ndërkaq komisioni vazhdoi me sugjerime se si të veproi lidhur me këtë çështje duke propozuar (shumica) që të vizitohet komuna e Prizrenit dhe Prevallci, dhe komisioni atje të hulumtoi vendimin e anuluar nga komuna etj në këtë mënyrë të monitorohet njëherit edhe ligji në fuqi, ngase në këtë rast kemi përgjegjësinë politike pse nuk zbatohet një ligj. Komisioni nxori :

## P Ë R F U N D I M

**Të vizitohet komuna e Prizrenit më 17.6.2008 lidhur me çështjen e parashtruar nga Ombudspersoni i Kosovës-dëmtimi i malit të Sharrit me ndërtime ilegale.**

**Të vizitohet fshati turistik Prevallci, sidomos vendet ku janë lejuar ndërtimet ilegale dhe gurthyesit.**

**Pas vizitës , ti rekomandohet Kuvendit të Kosovës lidhur me veprimet që duhet të ndermirën më tutje.**

**Të ndryshme**

**Blerim Vela** njoftoi për planin konkret të OSCE rreth vizitave, ndërsa komisioni nxori :

**P Ë R F U N D I M**

**I. Në fillim të Shtatorit të vizitohet Kroacia , pasi që i njëjti shtet me sukses ka filluar të zbatoi rregullat e BE nga fushveprimtaria e këtij komisioni, ndërsa pak më vonë do të vizitohet Sllovenia dhe Maqedonia (ose Bullgaria).**

**II. Administratori i Komisionit bashkërisht me përfaqësuesin e OSCE mund të kontaktoi ambasadat e vendeve të cekura më lartë lidhur me këto vizita.**

Mbledhja përfundoi në orën 15,00.

**Bajram Badivuku**  
Administrator i Komisionit,

Kryetari i Komisionit,  
**Lulzim Zeneli**

